

GJENDJA E KËRKIMEVE ONOMASTIKE NË LUGINËN E PRESHEVËS DHE TË BUJANOCIT

ONOMASTIC RESEARCH SITUATION IN PRESHEVA AND BUJANOC VALLEY

Bahtijar KRYEZIU

1. Disa të dhëna për Luginën e Preshevës

*Lugina e Preshevës*¹, të cilin territor serbët e njohin si *Južna Srbija* (Serbia Jugore), herë-herë edhe si *Preševska kotlina* (Lugina e Preshevës), e tashti si një kundërvënie ndaj emërimit të shqiptarëve *Kosova Lindore* edhe si *Jug centralne Srbije* (Jugu i Serbisë Qendrore) përfshin tri komuna: Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën, të cilat komuna administrativisht tani i takojnë Republikës së Serbisë.

Duke pasur parasysh distancën gjeografike dhe ndarjen fizike të komunës së Medvegjës nga ajo e Bujanocit dhe e Preshevës, në këtë vështrim do të marrim vetëm gjendjen e kërkimeve onomastike në territorin e Preshevës e të Bujanocit.

Territori i komunës së Preshevës dhe ai i komunës së Bujanocit përfshin rreth 725 km². Në anën jugore kufizo-

het me Republikën e Maqedonisë, ndërsa pjesa perëndimore e tij shtrihet përgjatë vijës administrative që e ndan nga Kosova. Në anën lindore dhe në atë veriore kufizohet me komunat e RS-së (Pçinjin përkatësisht Vranjën). Pjesa më e madhe e këtij territori është e banuar me popullatë shqiptare. Sipas regjistrimit të vitit 2002 të Republikës së Serbisë (të cilin regjistrim shqiptarët e bojkotuan) thuhet se në këtë territor jetonin 54779 ose rreth 77% shqiptarë dhe 17766 ose rreth 23% serbë.

2. Lugina e Preshevës në sytë e studiuesve tanë dhe të huaj

Kjo zonë ka një lëndë onomastike të pasur dhe mjaft të larmishme. Ndonëse edhe këtu, si shumëkund gjetkë në trevat verilindore të shqipërisë, ka edhe prani të elementeve alogjene turke, sllave, greke, latine, arumune, prapëse-

prapë elementi shqiptar mbizotëron, sidomos në mikrotoponimi, në veçanti në fshatrat me popullatë shqiptare, si dëshmi e pranisë së kësaj etnie – dardanëve në këtë anë që nga antikiteti e deri më sot, përkundër pohimeve të disa dijetarëve sllavo-maqedonas të cilët shqiptarët i shohin në këto troje vetëm nga shekulli XVII e XVIII².

Edhe shumë emërtime që dalin si të huaja, janë të formuara nga shqiptarët, të cilët nën ndikimin e administratës së popujve të ndryshëm e të gjuhëve të tyre, gjatë historisë, kanë krijuar emërtime joshqipe, gjë që, për shkaqe të njohura, nuk ka ndodhur e kundërta.

Onomastika e këtij krahu, ashtu si edhe e disa fshatrave të tjera shqiptare përreth, deri më tani nuk është marrë sa duhet në shqyrtim nga studiuesit tanë. Bën përjashtim ndonjë studim i rrallë në fushën e dialektologjisë (Akademik Idriz Ajeti), të historisë (Selami Pulaha, Dr. Skënder Rizaj, Dr. Sabit Uka), të gjeografisë – demografisë (Akademik Hivzi Islami), të toponomastikës (Akademik Rexhep Ismajli), të arkeologjisë (Dr. Jahi Murati) ose edhe ndonjë punim i autorit të këtij shkrimi³. Ndërkaq shumë më tepër trajtime, studime e monografi nga kjo anë (vetëm në kemi pasur në dorë mbi 25) kemi ndeshur te autorët sllavë**, të cilët, me ndonjë përjashtim, kanë ecur pas hullisë së politikës, duke u përpjekur me çdo kusht të çojnë në vend amanetin që u kanë dik-

tuar interesat politikë të vendit të tyre – siç do të thoshte profesor Emil Lafe, e “për të provuar diçka të paracaktuar” – siç ka thënë kaherë patriarku i gjuhësisë shqiptare, Eqrem Çabej.

Puna që kemi bërë për të paraqitur një kumtesë me temë të këtillë në këtë Konferencë të rëndësishme për ndriçimin edhe të shumë çështjeve të tjera në fushën e albanologjisë, ka për qëllim që, përveç të dhënave të ofruara për autorët dhe studimet e hulumtimit e tyre të bëra në fusha të ndryshme studimore, të nxjerrë në pah edhe një material onomastik të trevës në fjalë, duke bërë përpjekje të veçojmë atë, sidomos nga pikëpamja diakronike. Për çështjen e shtruar, përveç materialit të vjelë në terren, kemi pasur parasysh edhe një numër hartash, regjistrash e defterësh të periudhave të ndryshme kohore si dhe literaturën e shqyrtuar në gjuhën shqipe, sllave dhe (sa që e mundshme) osmano-turke.

Në këtë kontekst kujtojmë se nuk janë pa interes të shihen, bie fjala, emërtimet e trevave: *Karadak e Hashani*; e qytezave: *Bujanovc e Preshevë*; e oikonimeve: *Gjergjec, Qarr, Qukarkë, Kurbali, Lilancë, Lopardincë, Maltërrnoc (Dushkërrnoc), Rakovc, Samolicë, Turi...*; topoelksemat (me bazë fjalët shqipe): *B(j)eshka, Bria, Firishta, Gropishta, Kepi, Çuka, Ligata, Rrahishta, Balltaki, Kunga...*, si dhe disa patronime, po ashtu të formuar me rrënjët e fjalëve shqipe: *Baravant, Bardhiçt, Bërnjasht, Dodajt, Dukajt, Hutajt, Koslosjant, Lumjant, Ukajt, Vrenezt* etj.

3. Toponimet

Po të marrësh në vështrim emrin *Karadak*, emër i një krahine kodrinore-malore të kësaj zone, që në këtë formë edhe më së shumti përdoret, del se fjala është për një emërtim me etimologji turke, por që nga pjesëtarë të popujve të ndryshëm e dëgjojmë edhe si: Crna Gora, që mund të jetë një përkthim i Malit të Zi, ashtu si dhe në Pukë me rrethinë, nga se në shekullin XV ndeshim emërtimet Mali Ixii, Malisium, Malici, pastaj Montagna Nera – përkthim nga italishtja⁴ etj. Një fshat afër Bujanocit mban një emër të ngjashëm me të kësaj krahine – *Karadniku*, që sigurisht lidhet me etimologjinë e fjalës turke *kara* “i zi” dhe morfema *-(d)nik*.

Një tjetër krahinëz e kësaj ane quhet *Hashani*, që paraqet një territor të veçantë, me të cilin emër banorët e rrethinës dhe ata të Hashanisë e njohin këtë trevë. Në fshatin Breznicë të Bujanocit, jo larg Hashanisë, edhe sot ruhen gjurmët e një varri që quhet *Vorri Hashankes*, si dëshmi që dallon banorët e kësaj treve nga të tjerët. Edhe në Strezoc të Preshevës ekziston një lagje me emrin *Mahalla Hashan've*, në të cilën dikur, ka pasur shtëpi me mure, një kishë dhe “*ašanske trle*” (tëbane të hashanëve), popullatë me prejardhje nga rrethina e Vranjës⁵.

Emrin *hashan-i* e ndeshim edhe në Cernicë të Moravës së Epërme me kuptimin “*bari delesh*”, por këtu mendohet edhe për një njeri të vrazhdë, me

sjellje të paarsyeshme, kurse fjala *hashajkë-a* në fshatin Jezerc të Ferizajt del me kuptimin “*racë e mirë delesh, të cilave u bie leshi këmbëve*”⁶.

Edhe në fshatin Sinaj të Podgurit të Dukagjinit qenka një mëhallë me emrin (*H*)*Ashani*, me 10 shtëpi, i pari i së cilës paska ardhur nga (H)Asi i Beranit rreth viteve 1770⁷. Një lagje me llagapin *Hashan* e ndeshim edhe në Obiliq afër Prishtinës, një tjetër në fshatin Muçivërc të Kamenicës etj. Hashanët si barinj endacakë përmenden edhe në rrethinën e Leskovcit. Një studiues serb, Petar Vlahoviq, duke shkruar për këtë etni thotë se të gjithë ata të cilët janë marrë me studimin e nomadëve e të nomadësisë ballkanike në përgjithësi, me të drejtë pohojnë se nuk u dihet zanafilla disa grupeve të këtilla, megjithëse, shton ai, nga sa dihet deri më tash, mund të flitet kryesisht për tri grupe: ata ose janë ilirë të fisit tauteriat; ose janë ardhës nga Shqipëria (shek. XIV) dhe grupi i tretë – grekët, të cilët e kanë lëshuar vendin (shek. XVIII) për shkak të kushteve të rënda jetësore gjatë sundimit të Ali Pashë Janinës⁸, që sipas nesh edhe këta mund të kenë qenë shqiptarë. Këtë mendim e përforcojnë disa emra të hershëm që përmenden si *Balaska* etj., ose fjalët: *pite, fasule, gomar, mustaqe, groshë, soj, kallamoq* etj., që i ndeshim te “*Ašanski rečnik*” – një listë fjalësh të D. Gjorgjeviqit⁹.

Hashanët nga sllavët janë trajtuar si vllahë dhe janë quajtur si (*H*)*ašani* ose *Asani*¹⁰, që në një mënyrë a ne një tjetër

dëshmon për një popullsi josllave në këto anë, e mbase për vazhdimësinë e pranisë së shqiptarëve gjatë shekujve në këto tërthore. E tërë kjo na bën të besojmë se Hashania është një trevë e banuar me shqiptarë që prej kohësh të hershme, e që si profesion kanë pasur e pjesërisht e kanë edhe sot blegtorinë.

Presheva – është oikonim i vjetër. Përmendet që në vitin 1381. Konsulli austriak J.G. Hahn emrin e këtij vendbanimi e ka shënuar si *Dorf Preshevo*. Është qytezë me popullatë të përzierë, ku shumicën e përbëjnë shqiptarët. Banorët e gjakut Shehu të fisit Sopi njihen si shqiptarët më të vjetër këtu. Sipas dr. Momčilo Zlatanoviçit emri *Preshevë* vjen nga antroponimi *Presh* + morfema *-evo*, kurse studuesi ynë Rexhep Ismajli, me gjithë vështirësitë që i sheh në shpjegimin e kësaj toplekseme, thotë se ky emër mund të shpjegohet po nga fjala bazë *presh*, që vjen nga greqishtja e vjetër *prason*, me prapashtesën sllave *-evo*, si te *Kraljevo*, *Valjevo*, por duke e paraqitur atë në një rrafsh me disa emra të tjerë vendesh të krijuar nga emra bimësh që në Greqinë antike: *Kronyôn* “*Qepë*”, *Parasiai* “*Presh*”¹¹ etj. Edhe ne hëpërhë nuk qemë të zot të gjejmë ndonjë shpjegim tjetër për këtë emërvend.

Bujanoci - është po ashtu një qytezë në Luginën e Preshevës me popullatë të përzierë. Ka një emër mjaft të vjetër, në territorin e të cilit në parahistori kanë jetuar dardanët. Në vitin 1381 e ndeshim si *Gojanovci* (nëse nuk është

gabim alternimi i shkronjës nistore b>g). Statusin e qytezës e ka fituar diku nga viti 1895, ndërkaq atë të qendrës komunale pas LDB (1945)¹². Disa thonë se emri *Bujanoc* del nga sllav. *bujan* (*bujna* – “*vend ku vegjetacioni rritet shpejt*”), por ka edhe mendime se ky toponim mund të heq rrënjë edhe nga e.p. *Buj+an* + morfema *-o(v)ci*.

Gjergjeci – është fshat i Malësisë së Bujanocit (Hashanisë). Emri i fshatit përmendet që në vitin 1445 në regjistrat turq. Sipas regjistrimit të vitit 1519, Gjergjeci kishte 20 familje, kurse sipas atij të vitit 1528 - 16 familje, të gjitha të krishtera¹³. Sot është tërësisht i braktisur. Emri i fshatit paraqitet në dy forma: nga serbofonët quhet *Djordjevac* ose edhe *Djurdjevac*, me kalimin *o > u* në rrënjë të fjalës, proces fonetik i cili në serbishten veriperëndimore është i ligjshëm, kurse nga shqipfolësit quhet *Xherxhec-i* (nga ata të rrethinës edhe *Xherxhevc-i* e *Xherxhefc-i*). Te prapashtesa *-evc*, së pari kemi këmbimin e *v-së* në *f*, duke u reflektuar në *-efc*, prej nga, më vonë, për lehtëshqiptim, bie edhe *f-ja* dhe është përfutur prapashtesa *-ec*. Duke pasur parasysh shumë mikrotoponime me etimonlogji shqipe, si dhe fakte të tjera historike të shtrirjes së popullatës shqiptare, në veri deri te Nishi, e në lindje deri te qyteti Tërn në Bullgari¹⁴, si dhe shtrirjen e fiseve ilire në pjesën më të madhe të territorit të ish-Jugosllavisë, mund të pohohet me vërtetësi se ky oikonim ka ruajtur emrin nga antroponimi mesjetar shqip-

tar *Gjergji-i*, si themelues i këtij fshati, ngase “*katundet fisnore shpeshherë mbajnë emrin e themeluesit ose të banorit të parë të tyre*”¹⁵, rrugë të cilën e përligj edhe emri i topikut tonë në vështrim – *Gjergjeci*.

Kërshëvica – është fshat gurinor, jo larg Bujanocit, i banuar me popullatë serbe. Me këtë emër në fshatin Priboc, po të kësaj komune, kemi ndeshur edhe mikrotoponimin *Kërsha (Tahiroviçe)*. Është topoleksemë njaft e përhapur në tërthoret e banuara me shqiptarë, si: *Kërshi Madh, Kërshi Vogël* në Busovatë të Kamenicës; *Kërshovit* - lagje e fshatit Ramabuçë e fisit Kastrati etj. Këtë emër e ndeshim edhe në vise të banuara me sllavë e rumunë. Mile Tomiq¹⁶ përmend 11 mikrotoponime në disa fshatra rumune me bazë fjalën (*k(ë)rrsh*). Në Kroaci kemi qytetin *Krško* me centralin atomik, kurse M. Shimundiq, në një studim të tij për rrethinën e Shibenikut, patronimin *Kršibašić* e paraqet të shekullit IX dhe një lagje patronimesh të tjera më të reja, si: *Kršak, Kršan, Kršanac, Kršić* etj., duke mos qenë i sigurt për prejardhjen e fjalës *krš*¹⁷, që bazuar edhe në shtrirjen e saj, mund të na shpjegë te një prejardhje e gjuhës sonë, me kuptimin e një “*vendi karsh, gurinë*”.

Dy fshatrat e kësaj nahije: *Korbevci* (në verilindje të Vranjës) dhe *Kurbalija* (në rrethinën e Preshevës), sipas nesh, kanë për bazë një zoonim, që lidhet me emrin e korbit, vende ku kishte shumë korba. Fshatrat dalin të shënuara që në regjistrat e shek. XVI¹⁸ dhe të cilë-

suar me “*Arbanas*” deri në luftërat serbo-turke të vitit 1877-78¹⁹. Në fshatin Sedllar të Hashanisë kemi ndeshur disa familje po me emrin *Korbi*, që del si një patronim i vjetër shqiptar i tipit toponimik, me prejardhje nga lat. *corvinus* “*korb*”²⁰, me këmbimin e *v>b* në rrënjë të fjalës.

Një oikonim i kësaj ane - *Llukari* (fshat jo larg Bilaqit të Bujanocit), skaj të cilit kalon rruga që lidh Preshevën me Pčinjin dhe mikrotoponimi *Llukoci* i fshatit Breznicë, me gjithë disa mendime të shprehura se toponimet e tilla janë të etimonit sllav. *luk* “*qepë*”, më shumë ka të ngjarë të kenë për bazë një antroponim mesjetar shqiptar *Lluk(ë)-a*, siç e ndeshim, bie fjala, te shqiptarët e krishterë, p.sh.: David Luka etj.

Lilanca - është oikonim tjetër që shtrihet afër Moravës Jugore, komuna e Bujanocit, i banuar sot kryesisht me popullatë serbe. M. Zlatanoviq duke përmendur këtë emërvend thotë se ka prejardhje nga antroponimi shqiptar *Lil*²¹, ashtu si edhe mikrotoponimi *Majrani* që shënon një kompleks arash të pëlleshme të fshatit Breznicë, i formuar po nga një e. p. shqiptar i besimit katolik, me veprimin e metatezës: nga *Marjan-i > Majran-i*.

Një fshat me popullatë serbe shtrihet jo më larg se 2-3 km në verilindje të Bujanocit. Fjala është për oikonimin *Lopardincë (Lapardincë)*, i cili përmendet që në vitin 1380. Filologu Momçilo Zlatanoviq e sheh të formuar nga baza e fjalës kelte + *ard* që ka të bëjë me “*një*

*vend të ngritur, pak të lartë*²². Por duke bërë fjalë për këtë toponim, ai nuk lë pa përmendur edhe fjalën shqipe *lop-ar*. Ne kujtojmë se, analogjikisht me disa toponime të tjera, edhe ky oikonomim mund të shpjegohet nga një vend – kullotë lopësh (shqip: *lop(ë) + ar(d) + i(n)cë-a*), ashtu siç i ndeshim edhe mikrotoponimet: *Capari Madh, Capari Vogël* në fshatin Breznicë të Bujanocit, fshatrat *Capar* te Gjilani, në Dukagjin etj., të formuara nga zoonimi *cap* (çjap).

Krejt afër Bujanocit shtrihet edhe fshati *Rakovac*, ku gjendet edhe Banja, një vend shëruës për shumë sëmundje.

Fshati duket të ketë prejardhje nga hipokoristiku *Rak*, si një përdorim mjaft i hershëm. Në anët e Novobërdës, në dokumente të vjetra, ndeshet si patronim: *Rachoiuich* (Rakojeviq), *Racheiuich* (Rakieviq), *Rachouac* (Rakovac), ndërsa më 1485 në rrethinën e Shkodrës del në formën e antroponimit – *Raku*, i biri i Lleshit, *Raka*, i biri i Palit etj. Trajtat *Raka, Rakaj, Rakiqi* etj., si patronime gjëllijnë edhe sot në tërthoret shqiptare dhe te popujt e tjerë ballkanikë²³, etimologjinë e të cilit duhet kërkuar te ndonjë nga gjuhët e lashta latine, greke, ilire – siç shprehet Mihailo Diniq²⁴, ose thjesht te ilirët, te antroponimi *Raccus* – siç thotë V. Georgievi²⁵.

Qarri (*Çarri*) – është një fshat tjetër i Malësisë së Bujanocit. Është emërtuar me termin e bimësisë sonë – fitonimin *qarr*, një huazim latin i shqipes, e që si

i tillë sikundër dihet, ka moshë të madhe, gjithsesi parasllave. Toponimet me toporrënjë të këtillë janë të shumta në vise të ndryshme të banuara me shqiptarë.

Qukarka - shënon një fshat me popullatë të përzierë skaj magjistrales Bujanoc – Shkup. Rrënjën e këtij oikonimi e kemi ndeshur edhe në mikrotoponimet e dhjetëra fshatrave të tjera të komunave Bujanoc e Preshevë.

Etimologjia e emrit *çuk(ë)-a*, që do të thotë “*majë mali a kodre*” është mjaft e ndërlikuar. Meyer, Mladenov, Weigand etj., e shpjegojnë nga sllavishtja. P. Skok e nxjerrë të burimit ballkanik mesdhetar të formuar sipas konfiguracionit të vendit,²⁶ kurse M. Tomiq²⁷ e paraqet me prejardhje të diskutueshme. Kohët e fundit disa gjuhëtarë maqedonas e paraqesin herë si fjalë ilire-trakase e herë si fjalë të dako-mizishtes²⁸.

Këto mendime e madje edhe dilema të dijetarëve sllavë për prejardhjen e kësaj fjale i japin dorë edhe më të fortë prof. E. Çabejt për të pohuar se është më tepër një fjalë vendi se një huazim sllav²⁹. Prof. I. Ajeti pohon se është toporrënjë me origjinë shqipe, duke e lidhur me emrin *sukë*, ku emri *sukë* nuk mund të ndahet nga *çukë*, forma e së cilës ruan fazën e vjetër me afrikatën *ç*³⁰. Tashti vonë edhe A. Omari thotë se është fjalë që ka të ngjarë të ketë hyrë edhe në serbokroatishte nga substrati ilir³¹ e jo anasjelltas.

Në anën e majtë të magjistrales Bujanoc-Preshevë gjendet *Samolica*

(e quajnë edhe *Smolica*), fshat mjaft i vjetër në këtë anë. Përmendet që në shekullin XV. Sipas regjistrimit të vitit 1981 fshati ka pasur 120 familje shqiptare dhe vetëm 8 serbe.

Rreth etimologjisë së këtij dhe emërtimeve si ky ka mendime të ndryshme: disa mendojnë se toponimet e quajtura kështu heqin rrënjë nga gjuha latine – romane *zmolje* “*tokë djerrë, djerrinë*”, të cilën Jokli e paraqet të ardhur nga lat. vulgare *e(x)mulgeo*³², me zgjerim të rrënjës me tingullin epentetik *a* + morfema sllave *-ica* etj. Megjithëkëtë shumë afër mendje është që baza e këtij oikonimi të lidhet me fjalën e vjetër *mal* të shqipes, e cila gjatë kohës, nën ndikimin e gjuhëve të tjera, sidomos sllave, të ketë pësuar edhe ndryshime të caktuara gjuhësore: të marrë një tingull protetik *s-* (siç e ndeshim edhe te mikrotoponimi *Sparasuri* – për *Paraspori* në fshatin Suharnë etj.) dhe prapashtesën sllave *-ica*, si shumë toponime e mikrotoponime tona. Si fjalë të vjetër shqipe – ilire e sheh edhe Milivoj Pavloviq, kur përmend një mëhallë me emrin *Smolica* të këtij krahu (krahaso il. *mol’mal* “sllav. *planiana* – *shqip mal*”)³³.

Turija e Bujanocit është fshat i vogël rrëzë një kodre, për etimologjinë e të cilit nuk mund të thuhet me siguri aq të madhe, sado që në literaturën e konsultuar kemi gjetur të thuhet se është krijuar në lidhje me kafshët e egra që jetuan dikur gjithandej. Këto ishin kafshë që quheshin *Tur*, *Zur* dhe *Llesh*. Ndër këto kafshë ishte një bishë-lopë

e egër që quhej *Tur*. Lat. *taurus* “*lloj taraku, byku*”. Si dëshmi e toponimeve që janë emërtuar (ndoshta) me një zoonim të këtyllë janë edhe toponimet *Turjanë* dhe *Turkovc* në rrethinën e Leskocit³⁴, *Turjaka* (Rahovec e Dukagjin), *Turjani* (Drenicë) etj.

Vlera të mirëfillta për studime, sikurse edhe në territoret e tjera të Ilirikut të dikurshëm, paraqesin mikrotoponimet, si shenja gjuhësore, ku më pak se te oikonimet ka prekur dora e pushtuesit. Andaj, po u shkel këmbë dhe u vështrua me kujdes territori në fjalë, shihet se dalin me qindra e mija toporrënjë tona - të gjuhës dhe të popullit që edhe i krijoi.

Kështu p.sh. në disa fshatra të këtij krahu kemi ndeshur mikrotoponime me fjalën *balltak-i*, e cila fjalë shënon një “*vend të ujshëm, moçalik*”, e që i përket fondit të fjalëve shqipe, nga *baltë-a* dhe prapashtesa shqipe *-ak*. Del mjaft prodhuese në fjalëformimin e shqipes. Se është një fjalë e vjetër shqipe, me gjithë ndonjë mendim tjetër, tregojnë edhe shumica e fjalorëve etimologjikë krahasimtarë. Vasmer, madje, e konsideron fjalë me prejardhje ilire³⁵. Në vise të ndryshme ku banojnë ose kanë banuar shqiptarët, me bazën e fjalës *baltë*, por me trajta të ndryshme, kemi shumë emra vendesh: *Baltalija*, fshat në rrethinën e Shtipit; *Baltak*, në fshatin Stubëll të Epërme³⁶, *Baltalik* në Bosnjë³⁷, *Ballçak* në Marec të Gallapit, *Balltaçet* - një plural në Gmicë të Kamenicës, e me veprimin e metatezës edhe *Batllaki*, në

fshatin Koretin të Kamenicës etj.

Edhe një kullotë e fshatit Priboc mban emrin *B(j)eshka*, të cilën fjalë Jokli e shpjegon nga shqipja **bie(r)shkë*, duke e lidhur me bie, pra “*vend i pjerrët, shpat*”, e të cilin mendim e përkrah edhe Çabej³⁸. Në të mirë të kësaj flasin edhe disa zgjerime të tjera shqipe: *bjeshkatar*, *bjeshkatarrë* etj. Se emërton një vend të lartë tregon edhe kjo: për një vajzë ose grua të madhe, të lartë, këndej thuhet “*â° bâ° si b(j)eshk*”.

Në fshatrat kodrinore-malore të kësaj ane nuk janë të pakta mikrotoponimet si: *Firaja Madhe* (në fshatin Gjergjec), *Firishta* (në Zarbicë), *Firi Dulles* (në Qarr), pastaj disa topolek-sema që përdoren në të folmet serbe, si *Firine*, plural për disa livadhe në Tërnovë³⁹ e *Fira*, një kodër në Preshevë; *Firza* (emër topografik në Mal të Zi dhe një emër vendi në Koman)⁴⁰ etj., që janë burime gjuhësore të shqipes, të formuara prej fitonimit *fier* dhe mjeteve të tjera prapashtesore, që shënojnë “*vende të veshura me fier*”.

Gropishta - quhen disa mikrotoponime në fshatrat Ramabuçë, Asllarë etj. Nga *gropë* + *ishtë-a* > *gropishtë-a*. Janë emërtime që shënojnë formën dhe pozicionin konfiguracionale të terrenit.

Fjala *gropë* ndër shqiptarë ka përdorim të gjerë e të vjetër, ndonëse në funksione dhe kuptime të ndryshme. Ndeshet edhe në formën *gropëz* - *gropëza*, që lidhet vetëm me shqip⁴¹. Kështu shkruan edhe P. Skok: “*Groppa neče biti iz lat. cruppa, nego ide zajedno sa rum.*

*groop**, kako već kod Meyera namazi, ali rum. *groop** potjecalo iz alb⁴². Emri *gropë-a* është shumë i shpeshtë edhe te shqiptarët e Kuçit. Në territorin e Plavës e të Gucisë ka mbi 30 mikrotoponime me këtë fjalë.

Gropa është edhe si emër katundi në Donji Zagarac, ndërkaq në shek. XIII del edhe si patronim, p.sh.: *Pal Gropa*, kryezot i Dibrës dhe i Ohrit, pastaj *Andrea Gropa*, i biri i *Pal Gropës*, si dhe *Zaharia Gropa*, njëri nga bashkëluftëtarët e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut⁴³ etj., gjë që dëshmon se emri *gropë-a* ka një shtrirje të gjerë në kohë e hapësirë.

Në fshatrat Norçë të Preshevës (një fshat mjaft i vjetër i cili në dokumente përmendet që nga viti 1379) e Rahovicë (fshat që përmendet nga shekulli XVI), si dhe në shumë fshatra të tjera, jo vetëm të kësaj ane, kemi ndeshur mikrotoponimin *Gurishtë*, formuar me rrënjën e fjalës së vjetër shqipe *gur* + *ishtë* “*vend me gurë, gurishtë*”, me bazën e së cilës, filologu shqiptar Spiro N. Kondo, vetëm në dokumentet antike ka gjetur afro 30 toponime. Se fjala *gur* është me etimologji shqipe, prej nga edhe shumë toponime, mikrotoponime e patronime të formuara me të, si: *gurinat*, *guraja*, *gurishte*; *Gurakuqi*, *Guranjaku* etj., në studimet e tyre shprehën edhe G. Mayeri⁴⁴, prof. M. Domi⁴⁵, I. Ajeti⁴⁶, G. Elezoviç⁴⁷, V. Pjanka⁴⁸, dr. M. Zlatanoviç⁴⁹ etj.

Shamaki - gjendet në fshatin Zhunicë të Preshevës, te një “*vend moçalor, bal-tak*” që shembet. Në fshatin Novosellë

të Bujanocit kemi ndeshur edhe një mikrotoponim tjetër që quhet *Kroi Shamakit* e që shënon po ashtu një vend të lagët, moçalik. Fjalën *shamak* Skok e paraqet si fjalë turke⁵⁰. Ne kujtojmë se këtu kemi të bëjmë me një emër prejfoljor të shqipes të ndërtuar nga folja *shemb* + sufiksi *-ak*: *shamak* < *shemak* < *shem(b)ak*, analogjikisht me emrin tjetër prejfoljor *Xhesinat* < *xhe(k)sinat* < *djegsinat* të fshatit Suharnë të këtij areali. E gjejmë edhe në fshatin Roganë (Rogaçicë) të Moravës së Poshtme si *Shamaki*, që shënon një vend të lagët që vazhdimisht shembet (shemet).

Një vend pak si i lartë si *kungë* < *gungë* në fshatin Ramabuçë ka marrë emrin *Kunga* (Imerit). Topoleksema *kungë-a* ndeshet edhe në të tjera anë të Kosovës. Në Roganë të Kamenicës dhe në Shalë të Bajgores del me temë të zgjeruar si *Kungullar-i*, që tregon një majë të rrumbullakët në arë ose në rrafsh.⁵¹ Përafërsisht kështu është shprehur edhe prof. L. Mulaku, duke thënë se mikrotoponimet e llojit *kungullar*, quhen kështu sipas formës si *kungull* që kanë kodrat⁵². Ne kujtojmë se fjala *gungë* (*kungë*) e trajtës serbo-kroate të Kosovës, të cilin prof. I. Ajeti e qet të hyrë në këto të folme nga idiomat shqiptare⁵³, shënon çfarëdo kodre të vogël *gungë* (*kungë*), si dhe çdo të dalë edhe në trupin e njeriut.

Në mes të Muhocit dhe Karaçevës së Epërme, një kompleks arash të cilat shërbejnë edhe si kufi ndërmjet këtyre fshatrave, quhen *Karrabati*. Edhe në

fshatin fqinj Roganë (Rogaçicë) të Kamenicës disa ara mbajnë emrin *Karrabatat*. Se a mund të lidhet baza e fjalës së këtyre mikrotoponimeve me trajtën e vjetër shqipe *grab* > *krap*, e me vepërimin e metatezës edhe *karp* - *karrab(ë)* + *atë* > *karrabat(ë)-i*, po e themi jo me siguri të madhe.

Në fshatin Breznicë, një mal me tokë të butë - ligatë, mban emrin *Kribare*, e cila topolekseme, me formën që ka del si një kompozitë e formuar nga dy fjalë: *krye* > *krie* (fjalë e gjuhës sonë) + sllav. *bare* "vend moçalik, kënetë".

Kupleci - emërton një vend me livadhe me një pozitë pak si të lartë në fshatin Zarbicë, që e kanë marrë emrin sipas konfiguracionit të tokës: nga *kumulec* > *kumplec* > *kuplec*, besojmë për lehtëshqiptim. Krahas kësaj fjale, në disa fshatra të kësaj ane përdoren edhe trajtat *tumulec* e *tumë*, me të cilat fjalë në gjuhën shqipe janë emërtuar vende që kryesisht janë të larta, që zakonisht shënojnë "majën e kodrës a të malit pa drurë"⁵⁴ dhe paraqesin një sinonimi.

Kepi - paraqet po ashtu një majë kodre të zhveshur në fshatin Zarbicë. *Kep-i* shpreh një "thep, majë në majë". Jokli gjen këtu, me të drejtë, një variant fonetik të *thep-it*, me ndërrimin e *c(k):th* që konsiston përbrenda shqipes⁵⁵. Edhe dr. R. Ushaku, duke shënuar mikrotoponimet *Kepi i Madh*, *Kepi i Vogël* në bregdetin e Ulqinit, thotë se këtu kemi të bëjmë me fjalëformime shqipe⁵⁶.

Në ndonjërin nga fshatrat e këtij krahu (Novosellë dhe Qarr të Bujanocit),

disa ara dhe livadhe të buta, kryesisht të lagëta, quhen *Ligata*.

Ligata “kënetë, terren me ujë moçalik” si toponim është mjaft i shpeshtë edhe në vise të tjera të vendit tonë. Sipas profesor Ajetit, në shqipet është derivat nga *lag* dhe prapashtesa e vjetër shqipe *-atë, -ata*, që nga pikëpamja gjuhësore mund të shpjegohet lehtë: prej *lagatë* > *lëgatë* > *ligatë*, ngase një tokë e tillë vërtetë është gjithnjë e lagët. Kalimi *a:ëi* është i ngjashëm si te fjalët: *livroj, livdoj* etj., ndryshim që është shkaktuar pas shpërnguljes së theksit nga rrënja në prapashtesë.

Se është fjalë e vjetër shqipe, ndoshta ilire, siç vëren prof. A. Xhuvani, dëshmojnë edhe toponimet *Ligatiçi* dhe *Ligate* në Bosnjë e Hercegovinë,⁵⁷ në ato vise ku dikur jetonin fise ilire.

Emrin *lak-u* e mbajnë disa livadhe, ku hetohen edhe sot gjurmë të një “rimske crkve”, mbase të kishës katolike shqiptare, në fshatin Bugarë (Slavujevc), i përmendur që nga shekulli XV, i banuar me popullatë të përzierë, ku dikuraskan jetuar tatarët⁵⁸. Është toporrënjë që gjithsesi duhet lidhur me shqip *lak*, pl. *leqe* “kthesë-a”, të cilin shpjegim, përveç në literaturën tonë e kemi gjetur edhe te prof. M. Zlatanoviçi⁵⁹, pikërisht kur bën fjalë për këtë mikrotoponim.

Në fshatin Breznicë, ndër Mëhallën e Poshtme, një shpat me shkurre quhet *Mikisha*, ku ende vërehen gjurmët e saj. Është formim yni i ngjashëm me: *Mbishkodër, Nënshkodër, Përterrugët, Temali, të*

të cilat mikrotoponime i përmend prof. Gjovalin Shkurtaç në punimin e tij: *Probleme teorike dhe metodike të studimit të onomastikës shqiptare*⁶⁰, të botuar këtu e tridhjetë vjet më parë.

Rrahishta - është topoleksemë që shënon një vend *rrahishtë-a* (nga *rrah* + *-ishtë-a*) “vend që dikur ka qenë mal, është çelur - hequr drutë dhe është shndërruar në tokë buke a kullotë”. Fjala *rrah*, si bazë e shumë mikrotoponimeve, ndeshet edhe te shkrimtarët tanë të vjetër, te disa fjalorë. E ka shënuar Gazulli, Çabej⁶¹ etj. Është fjalë e mbarë gjuhës, por me trajta të ndryshme, si: *Rrahishta* e *Te Rrahi* në Hashani, *Rrahi* në fshatin Tërpezë, *Rrahinat* në fshatin Jabllanicë, *Rrahat* e *Rrahmat* në anë të Drenicës⁶² etj., kurse emrin *Rrahmat*, ku ka vepruar edhe procesi i metafonisë *a:e:i*, e ndeshim afër Krujës⁶³.

Në fshatin Qukarkë, disa ara, afër një përrroske, mbajnë emrin *Shteku*, topoleksemë që ndeshet edhe në areale të tjera të banuara me popullatë shqiptare, e të cilin emërtim disa e shpjegojnë nga gjermanishtja: *stég* “broo, most”⁶⁴ (*dru për kalim, urë*), ndërkaq ne mbështesim mendimin e atyre dijetarëve të cilët thonë se kjo fjalë lidhet me rrënjorin e gjuhës sonë: *shteg(k)-u*, “vend i ngushtë nëpër të cilin mund të kalohet në anën tjetër...”, ashtu si edhe mikrotoponimi *Bria* i fshatit Ramabuçë të Bujanocit, emri *Brinje* i katundit në mes të Tivarit e Ulqinit, mikrotoponimi *Brinje* (në Bistricë të Sllovenisë - afër Mariborit), *Bria* (një kodër në formë

briri në fshatin Roganë të Dardanës etj. etj.), si fjalë e mbarë gjuhës, që nuk mund të ndahet nga pjesa anatomike *bri-ni: bri-ri* – siç ka theksuar me të drejtë akademik Idriz Ajeti⁶⁵.

4. Patronimet

Gjurmë lashtësie në këtë anë, përveç *oikonomimeve* e *mikrotoponimeve* të shënuara, paraqesin edhe *patronimet*, disa nga të cilat po i paraqesim më poshtë:

Balovit – është lagje e fshatit Gjergjec, e fisit Thaçi, që na kujton një patronim me bazën e antroponimit shqiptar *Balë-a*, ndoshta e burimit *kello-ilir* – siç e thotë edhe filologia Zvezdana Pavloviq⁶⁶. Afër Vranje ekziston edhe një emërvend që quhet *Balinooci* (edhe *ky*, pa dyshim, i dalë nga antroponimi *Balë-a*).

Bardhiqt – quhen kështu disa familje të fshatit Tërnavë, që kanë për rrënjë një fjalë të vjetër shqipe (forma e saj e hershme *Bardus*), e të cilën e ndeshim edhe te mbiemri i shkrimtarit tonë të vjetër, Frang Bardhi, si dhe në shumë treva të tjera të banuara dikur dhe sot me shqiptarë.

Baravant – shënon një lagje të fshatit Suharnë me 4 shtëpi të fisit Krasniqi. Besojmë se emri i lagjes rrjedhë nga një formë e vjetër shqipe - *Barban*, ashtu si edhe patronimet *Progon*, *Tanush* etj. Nga *Barban* > *Barvan* del patronimi *Baravan* si rezultat i ndikimeve të dukurve fonetike: të shtimit të tingullit zanor *-a-* dhe alternimit të *b > v*, ashtu

siç ndodh edhe te disa fjalë të tjera të gjuhës shqipe (*bagabond* > *vagabond* etj).

Bërnjasht - quhet kështu një lagje e fshatit Zarbicë të Bujanocit, që sot nuk ka asnjë shtëpi. Banorët e kësaj lagjeje bartin me vete emrin e fshatit të tyre të dikurshëm nga rrethi i Bujanocit - qarku i Vranjës (*Bërnjasha*), që sipas Skokut është fjalë shqipe e terminologjisë blegtorale (*brënjak*, *brinjak*): *brnja* + *ash* > *brënjash* > *bërnjash* që është një reliket nga iliro-trakishtja⁶⁷.

Çukali – është patronim i banorëve të një lagjeje tjetër të fshatit Priboc. *Çukali* vjen nga emërtimi i banorëve sipas emërtimit të formës së relievit (oronimit). Nga *çuk(ë)-a* “*majë kodre a mali*” dhe prapashtesa turke *-(a)li* > *Çukali-t*, e cila prapashtesë së bashku me disa huazime të tjera nga turqishtja ka depërtuar në gjuhën tonë dhe në disa gjuhë ballkanike⁶⁸, ashtu siç del edhe te patronimet e ngjashme: *Rekalit*, *Kishalit* etj. të këtij areali, për të formuar patronime si këto.

Në fshatin Zhunicë të Preshevës, si një emër i hershëm përmendet antroponimi - patronimi *Dedë*, banorët e të cilit gjak qenkan shpërngulur që herët nga këtej. Antroponimi *Dedë* është pa dyshim një emër i vjetër i shqiptarëve dhe i gurrës vendëse. Edhe *Dediqët*, si dhe *Dedincët*, patronime të dalluara të fshatrave të qarkut të Toplicës, heqin rrënjë nga antroponimi *Dedë*, *Deda*.

Në qytezën e Preshevës disa familje mbajnë *emrin Dodaj* (quhen edhe *Dodallart*), që heqin prejardhjen gjithësesi

nga një emër i etimonit tonë. Edhe në fshatin Bunushevc të rrethinës së Vranjës kemi ndeshur që si banor i parë të përmendet njëfarë Doda, pasardhësit e të cilit quhen *Dodaj* (serb. *Dodiqi*⁶⁹).

Dukajt – kanë këtë emër disa familje të një lagjeje të fshatit Raincë. S'ka dyshim se edhe këtu kemi të bëjmë me një fjalë të hershme. Historiani Selami Pulaha, duke folur për elementin shqiptar në disa krahina tona, përmend faktin se në regjistrimet e popullsisë gjatë shek. XV ndeshen një numër banorësh me emra të thjeshtë shqiptarë, ndër të cilët shënon edhe emrin *Duka*⁷⁰, madje vetë "*Dukagjinët e Arbërisë*", ku fjala e parë është një kompozitë: *Dukë-a* + *Gjin-i*, sipas disa të dhënave, përmenden madje që në shekullin VII.

Fanët - lagje e fshatit Priboc që sot nuk ka asnjë shtëpi. Në vitin 1981 lagja kishte 4 shtëpi të fisit Sopi. Del nga hipokoristiku i emrit personal i botës së krishterë që heq rrënjët nga greqishtja me kuptimin "*i dërguari i zotit*"⁷¹. Është një shkurtim i brendshëm i *Teofan-it* - *Fanit*.

Hutajt - lagje e fshatit Raincë që mban një emër të dalë nga një fjalë e mbarë gjuhës, zoonimi *hut* (*hutini*), siç del edhe te patronimi *Korbi* në fshatin Sedllar ose edhe te oikonimet *Kurbevc* (rrethina e Vranjës) dhe *Kurbalija* (rrethina e Preshevës) - nga zoonimi *korb*.

Patronimi *Hutajt* këtu ka funksionin e nofkës, si edhe emrat: *Derri* (një patronim tjetër për disa familje në Preshevë), *Kokoshi*, *Bufi* etj., të cilët emra

familjarë në dokumentet e shekullit XIV dhe XV ndër shqiptarë janë të shumtë.

Kërshovit - lagje me 4 shtëpi të fisit Kastrati në fshatin Ramabuçë. Është patronim i tipit toponimik që vjen nga një *karsh* > *kërsh* + *-ovit* > *Kërshovit*, siç u shprehëm më sipër edhe te oikonimi *Kërshovicë*.

Kishalit - lagje me 9 shtëpi të fisit Sopi në fshatin Zarbicë. Po ashtu është një patronim i tipit toponimik, që del nga leksema e shqipes *kishë*. Edhe sot lokaliteti ku jetojnë këta fshatarë quhet *Te Kisha* (*Kisha Madhe*). Analogjikisht me këtë kemi edhe shumë mikrotoponime, oikonimin *Kishavë* te Manastiri i Maqedonisë, topik që përmban po ashtu fjalën *kishë*, pra, nga *kishë* + *al-it* > *Kishalit* etj.

Kolosjant - janë banorë të lagjes së fshatit Priboc me 7 shtëpi të fisit Thaçi. Ky patronim rrjedh nga një emër personal i krishterë katolik, nga hipokoristiku *Kolë*, që tregon për praninë e popullatës katolike shqiptare që më herët në këto tërthore.

Lumjant - është një lagje tjetër e fshatit Zarbicë. Kemi të bëjmë me një patronim të toponimizuar që rrjedhë nga apelativi i shqipes *lumë-i*, e që është mjaft i përhapur në toponomastikën shqiptare, si te: *Lumkovë*, fshat në rrethin e Shkupit; *Luma*, krahinë gjeografike në rrethin e Kukësit; *Lumalasi* e *Lumësi*, fshatra të rrethinës së Korçës e Beratit etj.

Në listën e emrave që emërtojnë pjesë të trupit për emra familjesh, si

një dukuri e hershme bën pjesë, pa dyshim, edhe patronimi *Kryeziu*, emër i formuar nga konglutinimi: *krye + i zi*, analogjikisht me emrat familjarë: *Kryehekuri*, *Kryemadhi*, *Kryemiri* etj.⁷².

Është mënyrë mjaft prodhimtare e formimit të patronimeve që në mesjetë, me ç' rast patronimin *Kryeziu* e ndeshim edhe në formën e toponimizuar: vendbanimi *Kryeziu* – Pukë; *Krieza* (*Kryeza*) – fshat i Beotisë së Epirit; *Kryeziu* – vendbanim në rrethin e Kavajës etj. Në rrethinën e Bujanocit këtë emër e mbajnë banorët e lagjes së *Velevë* të fshatit *Zarbicë* si dhe *Çestelint* (*Qestelinët*) e fshatit *Novosellë* (të ardhur këtu gjatë shpërnguljeve të mëdha të shqiptarëve nga fshati *Qestelinë* i rrethit të Vranjës).

Është për të theksuar se në fshatin *Strezoc* të Preshevës një lagje serbe quhet *Shalinci* (më vonë *Stankoviqi*) që besohet se heq rrënjët, poashtu, nga një patronim i prejardhjes shqiptare – *Shala*.

Ukajt – është patronim i disa familjeve të fshatit *Raincë* që vjen nga antroponimi *Ukë-a*, një emër i vjetër i protoshqipes. Nën ndikimin e sllavishtes shumë patronime si *ky*, këtej i quajnë edhe si *Ukovit*, *Dukovit*, *Hutovit* etj.

Vrenezt – lagje me 1 shtëpi e fisit *Sopi* në fshatin *Priboc*. Besojmë se kjo fjalë vjen nga një emër personal: *vran* me kuptimin “i zi” që e shënon edhe P. Skok⁷³.

M. Pavloviqit për toponimin *Vrenez* të Letnicës së Karadakut të Shkupit, konstaton prejardhjen *ilire* të tij nga:

vorn > *varn* > *vrn* > *vrnez*, me kuptimin e një grope, vendgropë⁷⁴, prej nga mund të ketë dalë edhe patronimi *Vrenez* i fshatit *Priboc*. Ngjashëm me këtë, por me metatezë, kemi edhe patronimin *Vernez* në Prizren.

Përfundime

Për shkak të natyrës së punimit, përveç toponimeve e mikrotoponimeve të përmendura (*Karadaku*, *Hashania*, *Bujanoci*, *Presheva*, *Qarri*, *Gjergjeci*, *Kershovica*, *Rakovci*, *Lopardinca*, *Samolica*, *Qukarka*, *Lilanca*, *Karrabati*, *Kepi*, *Rrahish-ta*, *Shamaki*; pastaj patronimet: *Balovit*, *Bardhiqt*, *Bërmjashit*, *Çukalit*, *Dodajt*, *Dukajt*, *Hutajt*, *Kishalit*, *Kolosjant*, *Lumjant*, *Ukajt*, *Vrenezt* etj.), nuk do të ndalemi më gjatë te disa topopleksa të tjera të këtij krahu (shumica me etimologji shqipe), të cilat i ka trajtuar që më herët studiuesi ynë i njohur Rexhep Ismajli në punimin e tij: *Mbi disa toponime në Serbi të jugut dhe në Maqedoni të veriut*, siç janë oikonimet: *Bushtran* (që vjen nga fjala shqipe *bushtë* me formantin – *an*); *Leran* (nga fjala *lerë* + *-an*); *Shurdhan* (shqip: *shurdhë*, *shurdhoj*, e huazur nga lat. *surdus*, e cila në toponimi te arumunët ndeshet edhe si *Surdul*, *Surdulica*); pastaj fshatrat *Bukurovc* e *Miratovc* (që të dytë me bazë fjalën shqipe dhe formantin sllav – *ovc*); *Tërnavë* e *Tërrnovc* (nga *trn* + *-av(ë)* dhe *-ovc*) – fshatra me etimologji sllave⁷⁵, përkatësisht parasllave⁷⁶, i pari në komunën e Preshevës kurse i dyti në atë të Bujanocit; *Maltërrnovc* (nga *Mali* i *Tërrnocit* – siç e thotë

edhe prof. Ismajli e jo nga *Mali Trnovac - Tërnovci i Vogël*, siç i thonë serbët), për të cilin fshat, gjatë hetimeve tona kemi ndeshur të quhet edhe *Dushktërro(v)c*, emërtim që e përligj edhe më mendimin e prof. Rexhep Ismajlit); pastaj topiku *Geraj* (që vjen nga patronimiku *Geraj* i fshatit Norçë të komunës së Preshevës, i shek. XIV), topoelksema *Dupilla* e fshatit Nasalcë (formuar nga *tu-* + *pylli-a*, ku *y>i*, karakteristikë e të folmeve të këtij krahu)⁷⁷ etj.

Në këtë punim nuk u ndalëm as edhe te disa toponime e mikrotoponime të përhapura gjithandej, ku kanë jetuar ose jetojnë sot shqiptarët, të formuara me rrënjë fjalësh të mbarë shqipes tashmë të njohura, si: *ahu*, *ara*, *qafa*, *çurshia* (*qershia*), *dardha*, *fusha*, *kodra*, *kroi*, *lethia* (*lajthia*), *lisi*, *livadhi*, *lugaja a lugata*, *mali*, *mullini*, *prroi* (*përroi*), *roga*, *shpella*, *shpati*, *udha* etj.

Megjithëkëtë që u tha, para se të përfundojmë, e do puna të shtojmë se, si edhe në viset e tjera shqiptare, edhe në këtë areal, për shkak të gërshetimeve të mëdha ballkanike gjatë historisë që e kanë përcjellë etnosin shqiptar, ndeshen edhe mjaft onoma sllave: *Breznica*, *Strezovci*, *Debegllava*, *Dubrava*, *Gërlica*, *Gologllava*, *Jahovci*, *Javori*, *Ograda*, *Padinat*, *Perzhali*, *Resulat*, *Selishita*, *Jezeri*, *Zastoja*, *Zidinat*; turke: *Baç(j)a*, *Buzallaki*, *Karakolli*, *Vakofi*, *Huduti*, *Madenet*, *Sokaki*, *Ikdili*, *Çairi* (*ara*), *Çardaki* etj., pak emra të etimonit grek: (*Kroi*) *Xhorxhis*, *Manastiri* (*Qarr*), *Manastirishte* (*Novosellë e Preshevës*), *Sarmaxhiki* (*Samarxhiki - Qarr*),

Kallugjerica (*mal në fshatin Bilaq*) e ndonjë tjetër, ose edhe arumun: *Te Vllat* (nga fjala bazë vllah) etj.

Me këto pak të dhëna të paraqitura në këtë kumtesë, nuk mund të thuhet se është shterur së shqyrtuari e studiuar e gjithë ajo lëndë e vlefshme onomastike e Luginës së Preshevës. Është kjo vetëm një ndihmesë e modeste për të sensibilizuar dijen tonë se kjo trevë fsheh më vete shumë onoma me interes të shumëfishtë, jo vetëm për albanologjinë, aq më parë kur dihet se shumë nga këto emërtime vendesh (*oikonime e (mikro)toponime*), emra familjesh, vëllezërish e fisesh (*patronime*) *po bdarren* - siç do të thoshte Buzuku dhe *po shkojnë drejt tretjes si kripa në ujë*, siç shprehej me drojë profesor Eqrem Çabej, e të cilat, po edhe deshëm t'i kemi dikur, në qoftë se nuk mblidhen e studiohen sa më parë, nuk do t'i kemi ose do të jenë ndryshe nga ato që janë sot.

Summary

Presheva Valley includes three municipalities: Presheva, Bujanoc and Medvegja, which administratively belong to Republic of Serbia. Having into consideration the physical division of Medvegja Municipality, we will deal only with the onomastic research situation of Presheva and Bujanoc Municipalities, which territory has about 725 km², with about 77% of Albanian population and about 23% of Serbian population.

This area has a rich onomastic material and very variegated but not studied properly from our humanists. There are some exceptions for instance in the field of dialectology (academic Idriz Ajeti), in the field of history (Dr. Skënder Rizaj and Dr. Sabit Uka), in the field of demography (Academic Hivzi Islami), toponymy (Selami Pula end Academic Rexhep Ismajli), archeology (Dr. Jahi Murati), or even any of the works of the author of this research. Whereas much more works from this area (we had at least 25), we have found among Slav authors.

In this paper, although we have offered some information about the authors and their researches made in different fields, we have also tried to find out an onomastic material of the mentioned area, especially from the diachronic aspect. In this context we consider that it is interesting to see the denominations of the regions as Karadak and Hashani; of towns: Bujanoc and Presheva; oyconymys: Gjergjec (from Albanian - Gjergj), Qarr (from Fytonymy qarr), Qukarkë (from çukë - or sukë), Kershevicë (from karsh...), Kurballi (from zoonym korb), Lilancë (from p. noun Lil), Lopardincë (from zoonym lop(ë), as in Cap+ar, from cap), Maltërnoc (from mount of Tërrnoc - Dushk-tërrnoc), Rakovc (from Rak, perhaps an Ilyric noun), Samolicë (from Latin zmole, or from old Ilyrian-Albanian word mol; mal), Turi (from zoonym tur)...; then topolcksemat (on the bases

with Albanian words): B(j)eshka, Brja, Firishta, Gropishta, Kepi, Ligata, Rrahishta, Balltaki, Kunga, as well as some patronymes formed on the bases of the Albanian words: Baravant, Bardhiqt, Bernshajt, Dukajt, Kolosjant, Lumjant, Ukajt, Vrenezt etc.

Besides the mentioned toponyms and patronymic, we are not going to deal so much even with some other topolcksemat which were analyzed by Rexhep Ismajli in the work: On some toponyms in the South Serbia and North Macedonia, such are the oyconymes: Bushtran (from Albanian bushtër + -an); Leran (from the word lerë + -an); Shurdhan (Alb.: shurdhë, shurdhoj, borrowed from Latin surdus); then the villages Bukurovc and Miratovc (with Albanian base and Slavic formative - ovc); Tërrnovc (from trn + -ovc) - a village with Slavic etymology, respectively pre-Slavic: Maltërnovc (from Mali i Tërrnocit and not from Mali Trnovac - Tërrnovci i Vogël as the Serbs say); then the topic Geraj which comes from patronym Geraj from Norçë village from the XIV century), topolcksem Dupilla of Nasalcë village (formed from tu- + pylli-a, where y>i which is the characteristics of this area.

Even in the longer version of this paper we have not written down the overspread toponymes and microtoponymes over there that are formed with the now already known Albanian radix, such as: ahu, ara, qafa, fusha, kodra, kroi, livadhi, lugata, mali, përroi,

roga, shpella, shpati, udha, etc.

Although, similar to the other Albanian areas, even in this region, besides the denominations that derive from our language, there can be found a great number of Slavic words (onomas), as: Breznica, Strezovci, Dubrava, Gërlica, Gologllava, Ograda, Padinat, Përzhali, Resulat, Selishta, Zastoja...; Turkish: Baç(j)a, Buzallaki, Karakolli, Vakofi, Huduti, Madenet, Sokaki, Ikdili, Çairi (ara), Çardaki, etc. ... a few names of Greek etymology: (Kroi) Xhorxhis, Manastiri (Qarr), Manastirishte (Novosellë of Presheva), Sarmaxhiki (Samarxhiki - Qarr), Kallugjerica (a mountain in Bilaq village) and some other, or even in Roumanian: in Vllat (from the basic word vllah) etc.

With the presented facts, we cannot say that there is not further space for the study of all that valuable onomastic material of Presheva Valley. This is only a modest contribution in order to challenge our knowledge that this region keeps within many onomas with multiple interest not only for Albanology, because, as it known that many of these words vanish and fade away, as Buzuku would say, and if they will not be picked up and studied as soon as possible, we either will not be going to have them in the future or they will be different of that that they are today.

Bibliografia

1. Është marrë këtu në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë Karadakun dhe Malësinë e Bujanocit, i cili territor si tërësi quhet Kosova Lindore.
2. Petar Skoku, Jovan Trifunovski, Atanasije Urosheviqi etj.
3. Dr. Idriz Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanocit*, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978; Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV_XVI, Tiranë, 1984; Dr. Skënder Rizaj, *Moderna osmanlika vlast u vranjskoj i preševskoj kazi* (spisak sela), Vranjski glasnik VII, Vranje, 1971; Mr. Sabit Uka, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Serbia Jugore më 1877-1878 dhe vendosja e tyre në rrafshin e Kosovës, Zëri*, Prishtinë, 1991; Hivzi Islami, *Bujanovci dhe komuna e tij – kontribut njohjes së gjendjes dhe problematikës sociale-geografike*, Dituria, nr. 2-3, Prishtinë, 1971/72 dhe 1-2, Prishtinë, 1973; Rexhep Ismajli, *Mbi disa toponime në Serbi të jugut dhe në Maqedoni të veriut*, Gjurmime albanologjike, nr. 1-2, IA, Prishtinë, 1970, f. 261-267; Mr. Jahi Murati, *Fushëgropa e Preshevës – vendbanim parahistorik*, Rilindja, 19.2.1977, f.13; Dr. Bahtijar Kryeziu, *Onomastika e Hashanisë*, IA, Prishtinë, 2000, *Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanocit*, IA, Prishtinë, 2006 dhe artikulli i po këtij autori: *Shpërngulja e shqiptarëve të Malësisë së Bujanocit para dhe pas luftës së Kosovës të vitit 1999*, Rilindja, Prishtinë, 25.5.2001, f. 10-11; Jovan Hadjivasiljević, *Preševska oblast*, Beograd, 1913; Jovan F. Trifunovski, me këto monografi: *Komanovsko-preševska Crna Gora*, knj. 33, SANU, Beograd, 1951; *Vranjska kotlina I*, FPN, Skopje, 1962; *Vranjska kotlina II*, FPN, Skopje, 1963; *Moravica*, Godišen zbornik na filozofskiot fakultet na Univerzitetot, Skopje, 1948; *Bujanovac*, Glasnik etnografskog instituta SAN, Beograd, 1957; J. Trifunovski, *Preševo*, Glasnik srpskog geografskog društva II, Vranje, 1966; Tatomir P. Vukanović, *Bujanovac*, Vranjski glasnik II, Vranje, 1966 dhe *Preševo*, Vranjski glasnik II, Vranje, 1966; M.

Gjendja e kërkimeve onomastike në Luginën e Preshevës dhe të Bujanocit

- Kostić, *Vranjsko-bujanovačka kotlina*, Vranjski glasnik IV, Vranje, 1968; Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Moravice*, Vranjski glasnik XX, Vranje, 1987; Dragutin Djordjević, *Ašani u Leskovačkom kraju*, Leskovački zbornik XVII, Leskovac, 1977; Tatomir P. Vukanović, *Tradicija o nomadskim stočarskim kretanjima Karakačana na jugu Srbije*, Vranjski glasnik XXVI-XXVII, Vranje, 1993-1994; Dr. Aleksandar Stojanovski, *Vranjski kadiluk u XVI veku*, Vranje, 1985; Atanasije Urošević, *Novobrd-ska Kriva Reka*, knj. 32, Beograd, 1950; Jovan Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje*, Beograd, 1968; M. Zlatanović, *Nazivi geografskih termina u Vranjskoj kotlini*, SANU, Onomatološki prilozi I, Beograd, 1979; Zvezdana Pavlović - Stamenković, *Nazivi izvora u oblasti Polanice i Klisure*, Leskovački zbornik, Leskovac, 1971; Momčilo Zlatanović, *Ojkonimi Vranjske kotline*, Leskovački zbornik XXI, Leskovac, 1981; Milivoj Pavlović, *Toponimija okoline Vranja*, Vranjski glasnik IV, Vranje, 1968; M. Pavlović, *Oronimi Oblik i Sveti Ilija*, Vranjski glasnik VII, Vranje, 1971; Dr. Vidosava Nikolić - Stojančević, *Turska imovina u Vranjskom okrugu u vreme oslobodjenja 1877/88*, Leskovački zbornik VIII, Leskovac, 1977; Mr. Javorka Marinković, *Mikrotoponimija Vranja i okoline u književnom delu Borisava Stankovića*, Vranjski glasnik XXIV - XXV, Vranje, 1992; Gordana Tomović, *Vranje i okolina u srednjem veku*, Vranjski glasnik XXVI-XXVII, Vranje, 1993-1994 etj.
4. Shih: Rexhep Ismajli, *Mbi disa toponime në Serbi të jugut dhe në Maqedoni të veriut*, "Gjurmime alban.", IA, nr. 1-2, Prishtinë, 1970, 261-267 (duke cituar veprën e M. Shuffaj, *Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë, 1968).
5. Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Moravice*, Vr GI XX, Vranje, 1987, 118.
6. Instituti Albanologjik, Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore, Prishtinë, 1982, 132.
7. Svetozar Stijević, *Onomastika istočnog dela Metohijskog Podgora*, SANU, OP 1, Beograd, 1979, 311.
8. Petar Vlahović, *Neki međjuetnički dodiri i procesi na području Starog Vlaha*, Etn. pregled XII, Beograd, 1974, 81.
9. Dragutin Djordjević, *Ašani u Leskovačkom kraju*, *Leskovač zbornik*, XVII, Leskovac, 1977, 207, 220.
10. Tatomir P. Vukanović, *Tradicija o nomadskim stočarskim kretanjima Karakačana na jugu Srbije*, Vranjski glasnik XXVI-XXVII, Vranje, 1993-94, 299.
11. Shih: Reexhep Ismajli, punimi i cituar, f. 265 (citim sipas S. Konda, *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik*, Tiranë, 1964, f. 257).
12. T. P. Vukanović, *Bujanovac*, *Vranjski glasnik II*, Vranje, 1966, 69-71.
13. Dr. Aleksandar Stojanovski, *Vranjski kadiluk u XVI veku*, Vranje, 1985, 38.
14. Mr. Sabit Uka, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Serbia Jugore në vitet 1877-1887 dhe vendosja e tyre në Rrafshin e Kosovës*, Prishtinë, 1991, 34.
15. Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, 1977, 337.
16. M. Tomiq, *Toponimi srpskih i hrvatskih naselja u Rumuniji*, SANU, OP VII, Beograd, 1986, 221.
17. Mate Šimundić, *Nepoznata osobna imena i prezimena šibenskog kraja od XII stoljeća do novijega vremena*, SANU, OP IV, Beograd, 1983, 80.
18. Dr. Aleksandar Stojanovski, *Vranjski kadiluk u XVI veku*, Vranje, 1985, 150.
19. Dr. Vidosava Nikolić - Stojančević, *Turska imena u vranjskom okrugu u vreme oslobodjenja 1877-1878*, Leskovački zbornik VIII, Leskovac, 1968, 84.
20. Frano Luli, *Egrem Çabej, personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare*, Tiranë, 1998, 102.
21. Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Moravice*, Vranjski glasnik, XX, Vranje, 1987, 117.
22. Momčilo Zlatanović, *Ojkonimi vranjske kotline*, Leskovački zbornik, XXI, Leskovac, 1981, 211.
23. Prof. Skënder Hoxha, *Kontribut për studimin e toponimisë së Dushkajës*, Prishtinë, 1993, 17-18.
24. Mihailo Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva I*,

- Beograd, 1957, 81, 105 (citura sipas S. Hoxhës).
25. V.I. Georgiev, *Studime ilire II*, Prishtinë, 1978, 50.
26. P. Skok, *Etimologjiski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, Zagreb, 1971, 340.
27. M. Tomić, *Toponimi srpskih i hrvatskih naselja u Rumuniji*, SANU, Onomatološki prilozi VII, Beograd, 1986, 209.
28. Lj. Stankovska, *Geografskite termini vo toponimijata na Polog* (Zbornik radova savjetovanja o pitanjima standardizacije geografskih naziva u jezicima naroda i narodnostima SFRJ), Sarajevo, 1984, 223.
29. Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore IX*, Prishtinë, 1989, 141.
30. Dr. I. Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, 343.
31. Anila Omari, *Ndikime të gjuhës shqipe në të folmet jugore të serbishtes*, Gjuha shqipe nr. 3, Prishtinë, 1989, 29.
32. Shih: A. Konushevi, *Toponimia e Gjakovës*, Gjakovë, 2002, 200 cituar sipas Emil Lafe, *Toponime latine-romane në truallin e shqipës*, Studime ilire II, Prishtinë, 1978, 131.
33. Milivoj Pavlović, *Toponimija okoline Vranja*, Vranjski glasnik, IV, Vranje, 1968, 313.
34. Jovan V. Jovanović, *Neki tragovi starog privrednog I društvenog života u Leskovačkoj kotlini*, Leskovački zbornik IV, Leskovac, 1964, 107-108.
35. Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, 51-52.
36. Mehmet Halimi, *Mbi zhvillimin e disa fjalëve në të folmen popullore*, Jehona nr. 4, Shkup, 1976, 218.
37. P. Skok, *Iz toponomostike južne Srbije*, Glasnik skopskog naučnog društva XV-XVI, Skopje, 1936, 110.
38. Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1976, 68.
39. Momčilo Zlatanović, *Toponimija Preševske Crne gore*, Vranjski glasnik XIX, Vranje, 1986, 167.
40. Dr. Idriz Ajeti, *Po aty*.
41. Dr. I. Ajeti, *Veptra e cituar*, 344.
42. P. Skok, *Te Kritika*, Arhiv I, Beograd, 1923, 228-229.
43. Ali Harshova, *Bashkëluftëtarët e Skënder-beut*, Prishtinë, 1968, 54.
44. Gustav Mayer, *Die Sprache der atlen Illyrier I*, Wien, 1957, 153.
45. M. Domi, *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra*, Iliria nr.1, Tiranë, 1983, 11.
46. Idriz Ajeti, *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*, Prishtinë, 1994, 106.
47. G. Elezović, *Rečnik Kosovsko-metohijskog dijalekta*, Beograd, 1932, 72.
48. Vlogimjež Pjanka, *Toponomastika na Ohridsko-prespanskiot bazen*, Skopje, 1970, 156.
49. Momčilo Zlatanović, *Pun. i cit.*, 171.
50. P. Skok, *ERSHJ III*, Zagreb, 1973, 380.
51. Instituti Albanologjik, *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Prishtinë, 1982, 174.
52. Dr. L. Mulaku, *Nga toponomastika e Kosovës*, BPSH të FF, Prishtinë, 1963, 179.
53. Dr. I. Ajeti, *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*, Prishtinë, 1994, 105.
54. Mikel Ndreca, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1954, 578.
55. Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore I*, 90.
56. Dr. Ruzhdi Ushaku, *Kërkime filologjike*, Prishtinë, 1981, 232.
57. Dr. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, 348.
58. Momčilo Zlatanović, *Punim i cituar*, f. 116.
59. M. Zlatanović, *Punim i cituar*, f. 117.
60. Gjovalin Shkurtaj, *Probleme teorike dhe metodike të studimit të onomastikës shqiptare*, "Puka dhe shkolla", nr. 1, 1977, 73.
61. Dr. E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë, 1976, 85.
62. Mr. Rexhep Doçi, *Onomastika e shqiptarëve të Drenicës* (disertacion doktorature), FF, Prishtinë, 1989, 321.
63. David Luka, *Shënime mbi toponiminë e krahinës së Krujës*, Studime filologjike nr. 4, Tiranë, 1975, 97.
64. M. Zlatanović, *Punim i cituar*, f. 120.
65. Dr. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipës I*, "Rilindja", Prishtinë, 1982, f. 87-88.
66. Zvezdana Pavlović – Stamenković, *Nazivi izvora u oblasti Polanice i Klisure*, Leskovački zbornik XI, Leskovac, 1971, 122-123.
67. P. Skok, *ERSHJ I*, 215.

Gjendja e kërkimeve onomastike në Luginën e Preshevës dhe të Bujanocit

68. Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, 196-197.
69. Milivoj Pavlović, *Toponimija okoline Vranja*, Vranjski glasnik, IV, Vranje, 1968, 314.
70. Jusuf Shpuza, *Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve*, Shkodër, 1998, 83.
71. *Prosvjetni imenoslov*, Zagreb, 1984, 409.
72. Jusuf Shpuza, *Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve*, Shkodër, 1998, 28.
73. P. Skok, *ERHSJ III*, 1973, 617-618.
74. Milivoj Pavlović, *Punim i cituar*, f. 304.
75. Rexhep Ismajli, *Punim i cituar*, f. 268.
76. Petar Skok, *Vepër e cituar*, f. 504.
77. Rexhep Ismajli, *Punim i cituar*, f. 264-267.